



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 16.2.2023

Nr: 58

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

PËR LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 30, KZAZ NR. 31, KZAZ NR. 33, BASHKIA TIRANË, KZAZ NR. 42, BASHKIA KAVAJË, KZAZ NR. 91, BASHKIA FINIQ, DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 31, BASHKIA TIRANË

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 867 prot., datë 15.2.2023, ka kërkuar zëvendësimin e sekretarit të KZAZ nr. 31, dy anëtarëve të KZAZ nr. 31, bashkia Tiranë, dhe një anëtarë të KZAZ nr. 91, bashkia Finiq. Me shkresën nr. 892 prot., datë 16.2.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ nr. 30, bashkia Tiranë.

Lëvizja Socialiste për Integrim, me shkresën nr. 913 prot., datë 16.2.2023, ka kërkuar zëvendësimin e dy anëtarëve të KZAZ nr. 33, bashkia Tiranë, dhe KZAZ nr. 42, bashkia Kavajë.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 16.2.2023 Nr: 58
Ora: 11:00



“Për lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.30, KZAZ nr.31, KZAZ nr.33, bashkia Tiranë, KZAZ nr.42, bashkia Kavajë, KZAZ nr.91, Bashkia Finiq, dhe sekretarit të KZAZ-së nr.31, bashkia Tiranë”

V E N D O S:

1. Të liroj nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 30, KZAZ nr. 31, KZAZ nr. 33, bashkia Tiranë, KZAZ nr. 42, bashkia Kavajë, KZAZ nr. 91, bashkia Finiq, dhe sekretarit të KZAZ nr. 31, bashkia Tiranë, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të emëroj anëtarin e KZAZ nr. 30, KZAZ nr. 31, KZAZ nr. 33, bashkia Tiranë, KZAZ nr. 42, bashkia Kavajë, KZAZ nr. 91, bashkia Finiq, dhe sekretarit të KZAZ nr. 31, bashkia Tiranë, sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së, si dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja 1

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Tiranë	30	Rabiana	Lefter	Llanaj	PS	Anëtare
2	Tiranë	31	Ledion	Gjergji	Qirici	PS	Anëtar
3	Tiranë	31	Aisel	Myftar	Leka	PS	Anëtare
4	Tiranë	31	Nertil	Vladimir	Qirko	PS	Sekretar
5	Tiranë	33	Valbon	Çerçis	Brahimllari	LSI	Anëtar
6	Tiranë	42	Rezear	Saimir	Kumbara	LSI	Anëtar
7	Vlorë	91	Valentina	Ylli	Zotaj	PS	Anëtar

Lidhja 2

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Tiranë	30	Kelvin	Shyqyri	Skrela	PS	Anëtar
2	Tiranë	31	Florjan	Mehdi	Almadhi	PS	Anëtar
3	Tiranë	31	Albana	Bashkim	Suli	PS	Anëtare
4	Tiranë	31	Hektor	Illir	Balluku	PS	Sekretar
5	Tiranë	33	Blondi	Bilbil	Harka	LSI	Anëtar
6	Tiranë	42	Marsida	Lutfi	Dyrmyshi	LSI	Anëtare
7	Vlorë	91	Elsa	Fejzo	Ajdini	PS	Anëtare